

VENDIM
Nr. 798, datë 30.9.2015

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 1233, DATË 11.12.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË
SIPËRFAQES SË TRUALLIT TË PARKUT “RINIA”, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121, pika 1, e 124, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 1233, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama